



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2023, mori këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS - LOKALET AFARISTE NË TREGUN E QYTETIT

Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit nr.prot.01-016/01-0033569/23 datë 15.05. 2023 për miratim paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, pronën e paluajtshme të Komunës - Lokalet afariste në Tregun e Qytetit, në këtë përbërje:

1. z.Bahri Selimi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
2. z.Leutrim Krasniqi, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
3. z.Valon Demolli, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës
4. z.Haki Rudari, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës
5. z.Agron Kulla, anëtar nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e Vendimit nr.prot. nr.prot.01-016/01-0033569/23 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës 15.05.2023.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot.01-016/01-0033570/23
Podujevë, datë; 15 maj 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha